



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE			
Nejola Org. Org. Jedinica Org. Unit	MI/KM	Nr. Prot. Buj Prot. Prot. No.	1326/12
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	- 6 -	Data : Datum : Dere :	07.08.2012
PRINTIME / A			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Infrastrukture*  
*Ministry of Infrastructure*

**Ministri i Infrastrukturës**, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.2, dhe nenet, 46, 94 dhe 104 të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, nenin 38, paragrafin 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 dhe nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 4/2012**  
**PËR DHËNIEN E CERTIFIKATËS SË SIGURISË DHE AUTORIZIMIN E**  
**SIGURISË PËR NDERMARRJET HEKURUDHORE DHE MENAXHERËT E**  
**INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatave të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore dhe autorizimet e sigurisë për menaxheret e infrastrukturës hekurudhore të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të transportit hekurudhorë në Kosovë.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

1. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është organ përgjegjës për dhënien e certifikatave të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore dhe autorizimin e sigurisë për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të transportit hekurudhorë në Kosovë.

2. ARH lëshon certifikatat e sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore dhe autorizimin e sigurisë për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, jo më vonë se njëqindnjëzet (120) ditë pas pranimit të kërkesës.

3. ARH lëshon certifikata të sigurisë për operatorët e transportit hekurudhorë të udhëtareve, transportit hekurudhorë të mallrave, mjeteve lëvizëse hekurudhore të mirëmbajtjes dhe mjeteve tjera të veçanta hekurudhore jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të kërkesës.

### **Neni 3**

#### **Llojet e autorizimeve të sigurisë në Kosovë**

1. ARH lëshon këto lloje të autorizimeve të sigurisë për menaxher të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë:

1.1 Autorizimin e Sigurisë për funksionimin/operimin e rrjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës hekurudhore (Autorizimi i Sigurisë A);

1.2 Autorizimin e Sigurisë për stacione hekurudhore dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) ( Autorizimi i Sigurisë B);

1.3 Autorizimin e Sigurisë për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes (Autorizimi i Sigurisë C);

1.4 Autorizimin e Sigurisë për operacione të kombinuara të rrjetit hekurudhor dhe infrastrukturës hekurudhore, stacione hekurudhore dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese), mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore (Autorizimi i Sigurisë D).

### **Neni 4**

#### **Autorizimet Evropiane të Sigurisë**

1. Autorizimi i sigurisë i vlefshëm, që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë nga menaxheri i infrastrukturës i lëshuar nga ndonjë organ i sigurisë i Bashkimit Evropian do të konsiderohet i vlefshëm në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

2. Pas pranimit për shqyrtim të autorizimit Evropian të sigurisë, ARH e njofton mbajtësin e autorizimit të sigurisë brenda tridhjetë (30) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për dizajn të sigurt, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës hekurudhore duke

përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe të sistemit të sinjalizimit para se ai të lejohet për të operuar.

## **Neni 5**

### **Autorizimet e sigurisë së Observatorit të Transportit për Evropën Jug-Lindore (SEETO-s)**

1. Autorizimi i sigurisë i vlefshëm, i lëshuar nga një organ i sigurisë pjesëmarrës në SEETO, nënshkruar të Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit, që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë nga menaxheri i infrastrukturës, do të konsiderohet i vlefshëm në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe Ministria ka apo arrinë marrëveshje me Ministrinë përkatëse të atij vendi për njohjen reciproke të autorizimeve të sigurisë.

2. Pas pranimin për shqyrtim të autorizimit të sigurisë SEETO, ARH e njofton mbajtësin e autorizimit të sigurisë brenda tridhjetë (30) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për dizajn të sigurt, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe të sistemit të sinjalizimit para se ai të lejohet për të operuar.

## **Neni 6**

### **Autorizimet e sigurisë të lëshuara nga vendet tjera**

1. Autorizimi i sigurisë i vlefshëm, i lëshuar nga ndonjë organ i sigurisë i vendeve të tjera që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë nga menaxheri i infrastrukturës, do të konsiderohet i vlefshëm në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

2. Pas pranimin për shqyrtim të autorizimit të sigurisë i lëshuar nga vendet tjera, ARH e njofton mbajtësin e autorizimit të sigurisë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për dizajn të sigurt, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe të sistemit të sinjalizimit para se ai të lejohet për të operuar.

**Neni 7**  
**Llojet e certifikatave të sigurisë vendore**

1. ARH lëshon këto lloje të certifikatave të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore në Kosovë:

1.1 Certifikatat e sigurisë për shërbimin e transportit hekurudhorë të udhëtarëve (Certifikatat e sigurisë U);

1.2 Certifikatat e sigurisë për shërbimin e transportit hekurudhorë të mallrave (Certifikatat e sigurisë M);

1.3 Certifikatat e sigurisë për shërbimin e transportit hekurudhorë të kombinuar të udhëtarëve dhe mallrave (Certifikatat e sigurisë U+M);

1.4 Certifikatat e sigurisë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore , mjeteve tjera lëvizëse hekurudhore speciale (Certifikatat e sigurisë S ).

**Neni 8**  
**Certifikata Evropiane e sigurisë**

1. Certifikata e sigurisë e vlefshme që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë nga operatori i lëshuar nga ndonjë organ i sigurisë i Bashkimit Evropian do të konsiderohet e vlefshme në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

2. Pas pranimin për shqyrtim të certifikatës Evropiane të sigurisë, ARH e njofton mbajtësin e certifikatës së sigurisë brenda tridhjetë (30) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për ofrimin e sigurt të shërbimeve të tijë në rrjetin përkatës. Këto kërkesa kanë të bëjnë me zbatimin e specifikimeve teknike të interoperabilitetit (STI) dhe rregullat nacionale të sigurisë, duke përfshirë rregullat operative të rrjetit, pranimin e certifikatave të stafit dhe autorizimin për të operuar me mjetet lëvizëse të përdorura nga aplikanti. Certifikimi do të bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi, siq përshkruhet në udhëzimin për aplikantët.

**Neni 9**  
**Certifikata e sigurisë së Observatorit të Transportit për Evropën Jug-Lindore (SEETO-s)**

1. Certifikata e sigurisë e vlefshme, e lëshuar nga ndonjë organ i sigurisë pjesëmarrës në SEETO, nënshkruar i Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit, që konfirmon pranimin e

sistemit të menaxhimit të sigurisë nga operatori, do të konsiderohet e vlefshme në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës, dhe Ministria ka apo arrinë marrëveshje me ministrinë përkatëse të atij vendi për njohjen reciproke të certifikatave të sigurisë.

2. Pas pranimit për shqyrtim të certifikatës së sigurisë SEETO, ARH e njofton mbajtësin e certifikatës së sigurisë brenda tridhjetë (30) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për ofrimin e sigurt të shërbimeve të tij në rrjetin përkatës. Këto kërkesa kanë të bëjnë me zbatimin e specifikimeve teknike të interoperabilitetit (STI) dhe rregullat nacionale të sigurisë, duke përfshirë rregullat operative të rrjetit, pranimin e certifikatave të stafit dhe autorizimin për të operuar me mjetet lëvizëse të përdorura nga aplikanti. Certifikimi do të bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi, siq përshkruhet në udhëzimin për aplikantët.

## **Neni 10**

### **Certifikata e sigurisë e lëshuar nga vendet tjera**

1. Certifikata e sigurisë e vlefshme, e lëshuar nga ndonjë organ i sigurisë i vendeve të tjera që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë, do të konsiderohet e vlefshme në Kosovë në qoftë se është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

2. Pas pranimit për shqyrtim të certifikatës së sigurisë të lëshuar nga vendet të tjera, ARH e njofton mbajtësin e certifikatës së sigurisë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

3. Aplikanti kërkon pranimin nga ARH-ja se ai ka përmbushur (plotësuar) kërkesat e nevojshme specifike për ofrimin e sigurt të shërbimeve të tij në rrjetin përkatës. Këto kërkesa kanë të bëjnë me zbatimin e specifikimeve teknike të interoperabilitetit (STI) dhe rregullat nacionale të sigurisë, duke përfshirë rregullat operative të rrjetit, pranimin e certifikatave të stafit dhe autorizimin për të operuar mjetet lëvizëse të përdorura nga aplikanti. Certifikimi do të bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi, siq përshkruhet në udhëzimin për aplikantët.

## **Neni 11**

### **Tarifat për autorizimin e sigurisë dhe certifikatën e sigurisë**

1. Lëshimi i autorizimeve, certifikatave të sigurisë është pa pagesë tre (3) vite pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Shpenzimet e mendimeve të ekspertëve të kërkuara nga ARH për lëshimin e autorizimeve, certifikatave të sigurisë do të mbulojnë nga ARH-ja.

3. Nëse opinioni i ekspertit të ARH-së kërkon masa shtesë që do të zbatohen nga aplikuesi në mënyrë që të siguroi lëshimin e autorizimit dhe certifikatës së sigurisë aplikanti duhet të mbuloi çmimin e opinionit të ekspertit dhe masat e nevojshme që duhet të ndërmerren.

### **Neni 12**

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për autorizim dhe certifikatën e sigurisë**

Procedurat për lëshimin e autorizimeve, certifikatave të sigurisë dhe të gjitha format dhe dokumentet e nevojshme do të përgatiten nga Organi i Sigurisë në kuadër të ARH-së dhe publikohen në faqen e internetit të ARH-së në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

### **Neni 13**

#### **Publikimi i Autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë**

Autorizimet, certifikatat e sigurisë të lëshuara për menaxher të infrastrukturës hekurudhore dhe operatorët hekurudhorë do të publikohen në faqen e internetit të ARH-së.

### **Neni 14**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 6 gusht 2012



Fehmi Mujota,  
Ministër i Infrastrukturës